REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.8364 prot. Himarë, më 05.11.2026

VENDIM

Nr.58, Datë 30.10.2026

PËR

"DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË ZNJ. JANULLA LLAZARI, QË NUK MUND TË PËRBALLOJË QIRANË E TREGUT TË LIRË, BANESA E TË CILËS ËSHTË SHEMBUR OSE DEKLARUAR TË PABANUESHME SI REZULTAT I ZJARRIT TË DATËS 04 SHTATOR 2026"

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 15, pika 5, të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", të ndyshuar, vendimit nr.301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët", vendimit nr.384, datë 12.06.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", vendimit nr.362, datë 29.05.2019, të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", bazuar në relacionin e grupit të punës, si dhe relacionin e përgatitur nga drejtoria e financës,planifikimit të buxhetit dhe menaxhimit të aseteve dhe drejtoria juridike, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 30.10.2026, miratoi me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim dhe si më poshtë:;

VENDOSI :

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare prej 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë për trajtimin me subvencionin e qirasë të znj. Janulla Llazari, që nuk mund të përballojë qiranë e tregut të lirë, banesa e të cilës është shembur ose deklaruar të pabanueshme si rezultat i zjarrit të datës 04 shtator 2026.

2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individin e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, do të jetë për një periudhë 1 (një) vjeçare, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Për individin, e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, kryerja e pagesave do të realizohet pasi të dorëzohet numri i llogarisë së qiradhënësit, pranë drejtorisë së financës,planifikimit të buxhetit dhe menaxhimit të aseteve, pranë Bashkisë Himarë.
4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i pikës 1 të këtij vendimi, do të përballohen nga fondi rezervë (Kod Programi 04910, Llog.Eko.609), vlerë e cila kalon në programin buxhetot të strehimit social (Kod Programi 10661, Llog.Eko.602) në buxhetin e vitit 2026 të Bashkisë së Himarës.
5. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë dhe drejtoria e financës,planifikimit të buxhetit dhe menaxhimit të aseteve, pranë Bashkisë Himarë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", *i përditësuar*.

KRYETARI
Dhimitër Kapaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË